



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 10.02.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. C- 203

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Hestet Cakolli, Gani Buçinca, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq .
Mungoi: Enis Kervan, Donika Kadaç-Bujupi dhe Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Takim me Asociacionet e të Diplomuarve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë- ADIPAL**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi debat lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës që të jetë si pikë e parë pasi Komisioni ka vendos të që në takim të ftojë përfaqësues nga Asociacioni i të Diplomuarve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë.

Pasi Komisioni u pajtua me këtë propozim, mbledhja vazhdohet me pikën e dytë të rendit të ditës.

1. Takim me Asociacionet e të Diplomuarve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë- ADIPAL.

Agim Veliu, kryetar – tha se Komisioni në mbledhjen e më hershme ka shqyrtuar kërkesën e Asociacionit të Diplomuarve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë(IPAL) dhe konstatoi se me këtë çështje duhet të merret MASHT dhe se çështja e zgjedhjes së studentëve duhet të rregullohet në bazë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

Pas kërkesës së përsëritur nga ana e ADIPAL, komisioni ka marrë qëndrim që në këtë takim ti thërras përfaqësuesit nga ky Asociacion dhe ti dëgjojë për çështjet në vijim: cilat janë kërkesat dhe pengesat që hasin pas përfundimeve të studimeve në Universitetet Private. Komisioni në bazë të të gjitha fakteve do të nxjerr Rekomandimin i cili do të shpejtojë procesin e përfundimit të akreditimit.

Kryesuesi fjalën ua dha përfaqësuesve të Asociacionit i të Diplomuarve në Institucionin Privat të Arsimit të Lartë.

Muhamet Koci – kryetar i Asociacionit të diplomuarve prezantoi se kërkesën e ADIPAL ua ka dërguar me shkrim disa here Komisionit. Kjo kërkesë ka të beje me pranimin e diplomave të studenteve në Universitetet Private me qëllim që të bëhet zgjidhjeje për vijimin e studimeve pos-diplomike (Master).

Ai tha se Asociacioni i të Diplomuarve është organizatë jo-qeveritare e cila është themeluar nga studentët e Universiteteve Private të Arsimit të Lartë me kërkesë që të mbrohen të drejtat e të diplomuarve, pasi të drejtat e tyre nuk janë të mbrojtura as nga opinioni i gjerë vendor dhe ai i huaj.

Qeveria e Kosovës ka nxjerr vendimin për mos lejimin e vazhdimin të studimeve pos-diplomike (Master). Me këtë vendim është bërë shkelje për vazhdimin e studimeve pos-diplomike në Institucionet e Arsimit të Lartë të Kosovës.

E drejta e Arsimimit të Lartë është e garantuar me Kartën e Bolonjës të cilën e ka pranuar edhe Republika e Kosovës me ç'rast studimet pos-diplomike i parasheh si studime bazike.

Asociacioni privat i të diplomuarve e përkrahë sistemin e Akreditimit, sepse është në interes të studentëve për ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë, ndërsa nuk përkrahë diskriminimin që bëhet ndaj të diplomuarve nga Institucionet Publike dhe ato Private. UP, është Institucioni i parë Publik i cili nuk njih titujt e Institucioneve Private dhe i cili Institucion me anë të mediave elektronike na ka bërë fyerje publike, duke deklaruar se jemi studentë të dobët. Në çdo formë janë shkelë të drejtat elementare të IPAL.

Ne studiuam në Institucione legale dhe hapi i parë për vazhdimin e studimeve ka qenë licencimit i tyre të cilin e ka lëshuar vetë Ministria e Arsimit.

Ne si studentë i kemi përmbushur të gjitha obligimet ndaj shtetit të ë Kosovës dhe iu kemi pagur taksat vjetore në vlerë prej 26%.

Në bazë të kërkesave dhe obligimeve që i kemi përmbushur, kërkojmë nga Institucionet Qeveritare që të hapet mundësia për vazhdimin e studimeve pos-diplomike (master).

Blerim Bici- Ai shprehi indinjatë të thellë se është bërë diskriminim për mosnjohjen e diplomave.

MASHT-i, përkatësisht Ministri, Enver Hoxhaj ka deklaruar se diplomat të cilat kanë licencë janë valide. Për fat të keq MASHT-i nuk ka lëshuar vendim me shkrim për njohjen e diplomave të Institucionet private.

Diskriminim është bërë për mos vazhdimin e studimeve pos-diplomike për këtë vit, është bërë fyerje nga ana e vetë Rektorit të UP, mos përkrahja nga ana e menaxherëve të Universiteteve private etj.

Brengat kryesore të Asociacionit do ti bazojmë në akte ligjore, pikë së pari në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në preambulë shkruan se jemi të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit.

Në neni 7 parashihen vlerat, këto vlera bazohen në barazinë e parimit të lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të Ligjit. Neni 47, parasheh të Drejtat për Arsimin. paragrafi 2 parasheh se çdo qytetar në Republikën e Kosovës ka mundësi të barabarta për tu arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij.

Çështje tjetër me rëndësi është Ligji për Arsimin e Lartë, ku neni 3, thotë se Arsimi i lartë kryhet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë për të gjithë personat në territorin e Kosovës në çfarëdo vendi pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë. Pra të gjitha Institucionet Publike dhe Private duhet të mbrojnë të drejtat e të arsimuarve.

Në bazë të diskriminimit po bëhet shkelja e Ligjit që është në fuqi.

Të drejtat tona si student duhet të mbrohen me Konventën e Bolonjës.

Kërkesat tona si Asociacion janë:

Kërkojmë nga MASHT-i që të dalë me një vendim me shkrim që të mundësojnë njohjen e diplomave të Institucioneve Private të Arsimit të Lartë (IPAL).

Të ofrohet zgjidhje konkrete për vazhdimin e studimeve pos-diplomike për këtë vit. Njohja nga ana e MASHT-it se 95% të profesorëve kanë punuar në UP.

Mark Krasniqi – përkrahë iniciativën për vazhdime pos-diplomike.

Ai parashtrori pyetje, se cilat janë pengesat për vazhdimin e studimeve, a duhet studimet pos-diploma të bëhet jashtë apo brenda shtetit të Kosovës dhe cili Institucion duhet ti mbuloj këto shpenzime.

Shprehë gatishmëri se Komisioni në bazë të kërkesave të parashtruara do të ofrojë përkrahje dhe do të dalë me një Përfundim për vazhdimësinë e studimeve master.

Heset Cakolli – përkrahu kërkesat e përfaqësuesve të IPAL, sepse me këtë çështje jemi të involvuar të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ai parashtrori disa pyetje konkrete.

Cilat Institucione Private të Arsimit të Lartë i përfaqësoni, gjatë studimeve në Institucione të Arsimit të Lartë licencimi a ka qenë vetëm për Bachelor apo ka qenë edhe për studimet master.

Ai shtoi se cilësia e studimeve është në nivel por është çështje e brendshme e Institucioneve Publike dhe Private se sa e njohin plan programin e UP.

Drita Kadriu – ajo kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e IPAL, dhe parashtroi këto pyetje: Se me cilin plan program punojnë punëdhënësit në Institucionet private dhe a janë ato të bazuara në plan program të UP, sa keni bërë vlerësim për punën dhe kontributin e menaxherëve dhe sa do të kontribuojë cilësia që të akreditohen këto Institucione.

Gani Buçinca - mbështetë angazhimin e përfaqësuesve të IPAL .

Diskutoi se Konventat Ndërkombëtare nuk respektohen as nga administrata ndërkombëtare e as nga Institucionet tona, ku me këtë fenomen do të ballafaqohen të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në vazhdim theksoi se asnjë Universitet nuk i pranon diplomat e Universiteteve tjera pa kaluar në procedurat e verifikimit me plan program të MASHT-it.

Në bazë të Autonomisë së Universiteteve, UP nuk ka obligim të pranojë që gjithë studentët për t'i vazhduar studimet në master.

Ai pyeti të pranishmit lidhur për këtë çështje:

Universitetet Private a e kanë marr licencën për ato drejtime të cilat nuk janë të përfshira në UP dhe sa i kanë përcjellë kriteret rreth akreditimit të paraparë me dispozitat ligjore.

Ne si Komision do të punojmë që t'ju hapen perspektiva për studime në kuadër të zgjidhjes së infrastrukturës ligjore.

Adem Hajdaraj mendon se Institucionet Publike dhe ato Private duhet t'i nënshtrohen kriterëve të cilat i parasheh MASHT-i.

Ai njoftoi se në bazë të informatave që ka dhe në bazë të deklaratës së Kryeministrit, nuk do të ndërpritet vazhdimi i studimeve për master.

Në vazhdim parashtroi disa pyetje rreth plotësimit të kushteve nga ana e MASHT-it.

Sa a janë bazuar që çdo Universitet Privat të ketë numrin e caktuar të profesorëve me tituj akademik, a është plotësuar numri i studentëve në Universitet (numri i student në bazë të Ligjit duhet të jetë 3000) dhe sa i kanë përcjellë kriteret rreth akreditimit të paraparë me Ligjin për Arsimin e Lartë.

Fatmire Berisha – diskutoi rreth çështjes së procesit të Akreditimit i cili proces mbështetet në zhvillimin e arritjes së studimeve cilësore.

Çështjen të cilën e parashtroi është; se ju si Asociacione private sa jeni të referuar në cilësinë e mësimdhënësve, arritjes së studimeve, planit dhe programit dhe personelit të pa mjaftueshëm akademik.

Procesi i akreditimit, i kontrollit siguron cilësinë dhe si i tillë duhet përkrahur.

Sa ju keni referuar ju si Asociacion cilësisë së mësimdhënjes, arritjeve të studimeve, personelit akademik.

Përfaqësuesit e IPAL-së pengesat dhe brengat e Asociacionit i kanë paraqitur duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Ata shprehën qëndrimin e tyre se problemet e krijuara me studentët e IPAL-së janë bërë nga vetë Institucionet tona, si ato të UP ashtu edhe nga Institucionet Private të Arsimit të Lartë. Meqë në kohën kur kemi filluar studimet, këto Institucione kanë pas licenca nga MASHT, pra baza ligjore për pranimin e diplomave ka ekzistuar gjë që kjo parashihet edhe me Ligjin mbi Arsimin e Lartë.

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë kërkohet që të mos diskriminohemi dhe të jemi të barabartë sipas ligjit që është në fuqi.

Agim Veliu-kryetar, theksoi se në Universitetet Private janë avancuar drejtimet të cilat janë të pa licencuara, ndërsa me kohë është bërë vërejtje me shkrim nga ana e MASHT-it. Ai theksoi se komisioni do kërkojë nga MASHT, që sa më shpejtë të përfundoj procesi i akreditimit i cili do të ndihmojë në arsimin Publik dhe atë Privat që studentët të kenë mundësin e lëvizjes ashtu si e parashih Deklarata e Bolonjës.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni pas shqyrtimit të shkresës së IPAL-së dhe pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, do të nxjerr këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjensioni i Akreditimit të përshpejtojë dhe të përfundojë me procesin e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë.
- II. Titujt Akademikë dhe Diplomat të specifikohen në çertifikatën e akreditimit .
- III. Të diplomuarve në Institucioneve Private të Arsimit të Lartë t’ju njihen Diplomat.
- IV. Të merren masat e nevojshme bashkë me Institucionet e Arsimit të Lartë që të mundësohet lëvizja e lirë e studentëve brenda dhe jashtë Kosovës ashtu siç parashihet me Deklaratën e Bolonjës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 3.02.2009.

3. Të ndryshme

Nga anëtarët e Komisionit nuk patë propozime për këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,45

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu